RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	*Nr. i lëndës*
Gjemajli Bellanica;	04.04.2022	12.04.2022	*81/22*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 31.03.2022 GOE **"NSHT Tissi & Bujar Shabani B.I",** ka parashtruar ankesë me nr. 81/22 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues, ku është rekomanduar për kontratë GOE " **Rahovica Comerce SH.P.K.; CAPITAL X FET SH.P.K**" lidhur me aktivitetit e prokurimit me titull: "**Asfaltimi i rrugëve në shtupeq të Madhë"**, me nr. të prokurimit: **635-21-4840-5-2-4**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KK –Pejë.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, Punë, vlera e parashikuar e kontratës: 156 579,28 €

Data e njoftimit për kontratë.....26.07.2021.
Hapja e ofertave.....17.08.2021.
Data e njoftimit të vendimit të AK-së.....27.08.2021.
Data e kërkesës për rishqyrtim.....01.09.2021.
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesës për rishqyrtim.....03.09.2021.
Njoftimi për dhënie të kontratës.....24.03.2022.
Data e kërkesës për rishqyrtim.....28.03.2022.
Ankesa e dytë në OSHP.....31.03.2022.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE TË: OE **"NSHT Tissi & Bujar Shabani B.I"**

Dispozitat e shkelura

Neni 56 - Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 114 - Përgjegjësitë e ekspertit shqyrtues dhe të autoritetit kontraktues

Neni 115 - Vendimi i autoritetit kontraktues

Neni 117 - Afati i fundit për marrjen e vendimeve

Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet

Kronologjia e aktivitetit te prokurimit

Me date 10.09.2021 kemi ushtruar Ankese ne OSHP, kundër Vendimeve te lartshënuara.
Me date 22.09.2021 kemi pranuar RAPORTTIN E Ekspertit Shqyrtues, Nr.675/21, si dhe Mendimin e Ekspertit shqyrtues, lidhur me pretendimet ankimore te parashtruar dhe te argumentuara.
Sipas Mendimit te Ekspertit Shqyrtues te gjitha pretendimet tona ankimore ne parashtruara dhe te argumentuara ne Ankesë, **kane qëndruar** dhe si rrjedhoje e kësaj Eksperti shqyrtues konforme nenit 114, paragrafi 2, te LPP-se, Përgjegjësitë e Ekspertit shqyrtues ka rekomanduar qe tenderi te kthehet ne **Rivlerësim**.
M mendimin e Ekspertit shqyrtues është **Pajtuar** Parashtruesi i ankesës ndërkaq Autoriteti Kontraktues , Komuna e Pejës **Nuk është Pajtuar.**
konforme Nenit 114, Përgjegjësitë e ekspertit shqyrtues dhe të autoritetit kontraktues,
Citoj dispozitën e nenit 114. Paragrafi 2.

Neni 114.2 Përgjegjësitë e ekspertit shqyrtues dhe të autoritetit kontraktues

2. Eksperti do të rekomandojë veprime korrigjuese e nevojshme që duhet të ndërmerren nga autoriteti kontraktues që mund të përfshijnë, sipas nevojës dhe varësisht nga rrethanat: (i) anulimin e aktivitetit të prokurimit, dhënies së

kontratës ose rezultati i një konkursi të projektimit (ii) zgjatjen e afatit kohor (iii) ndryshimin ose anulimin e një vendimi të autoritetit kontraktues dhe/ose (iv) marrjen e çfarëdo masave të tjera të nevojshme për të korrigjuar shkeljet e bëra nga autoriteti kontraktues.

AK, nuk ka marre veprime ka ndërmarrë masa te nevojshme konfrome Mendimet te Ekspertit shqyrtues por date 26.11.2021, ka kërkuar pëlqimin për validitetin e tenderit si dhe Sigurimin e tenderit për periudhën prej 90 ditëve.
Me date 28.02.2022 AK ka kërkuar prape validitetin e tenderit dhe sigurimin e tenderit.
Me date 28.02.2022 parashtruesi i Ankesës ka dorëzuar sigurimin e tenderit për periudhën prej 90 ditëve kalendarike si dhe ka konfirmuar validitetin e tenderit.
Prove; Sigurimi i tenderit për here te dyte i datës 28.02.2022.

Autoriteti kontraktues ne vend te zbatimit te Mendimit te Ekspertit shqyrtues dhe te ndërmarrjes se veprimeve korrigjuese dhe evitimin e shkeljeve te bere te dispozitave te LPP-se , ai ka injoruar Mendimin Ekspertit shqyrtues i cili ne Ekspertizën e tij ka konstatuar se Grupi i OE i propozuar për shpërblim te kontratës nuk ka përmbushur kërkesën e AK te përcaktuar ne paragrafin 9.&9.2 te FDT dhe atë;

Kërkesa 2 ;

Të paraqitët stafi që do të angazhohet në këtë projekt, të cilët drejtpërdrejtë janë përgjegjës në ekzekutimin e punëve dhe në përgjithësi të projektit duke përfshirë edhe stafin profesionale. – Stafi teknik (PUNONJËS) që do të kyçet në projekt -minimumi 15 punonjës
AK ka kërkuar nga OE qe te ofrojnë dëshmi dokumentare;
Dëshmia 2
Lista e punëtoreve me para kontrata minimum 15 punëtorë ose me Liste të ATK-së me pagese te kontributeve se paku 6 muaj te fundit
Grupi i OE i propozuar për shpërblim te kontratës ka ofruar dëshmi dokumentare për ketë kërkesë; Një liste te pagave te ATK te njërit anëtar te Grupit - **Rahovica Comerce SH.P.K** ku janë prezantuar vetëm 57 punëtor se bashku me dëshmitë mbi pagesën e kontributeve vetëm për 3 muaj e pare te vitit 2021 , ndërkaq ne Listën e Punëtoreve nga ATK-ja për anëtarin tjetër te Grupit; **CAPITAL X FET SH.P.K.**, janë prezantuar një liste me vetëm 14 punëtor për pagesën e kontributeve për 6 muajt e pare te vitit 2021.

AK ka kërkuar dëshmi nga ATK-ja për pagesën e kontributeve minimum për 6 muajt e fundit.
Nëse i qasemi kopjeve te kontratave te punës për punëtoret e anëtarit te grupit Rahovica Comerce shpk, do te shohim se te gjithë punëtoret kane kontrata me kohe te caktuar deri me 31.12.2021 , si dhe disa te tjerë me kohe te pacaktuar.

AK ne dosje te tenderit ka kërkuar qe OE duhet te ofroj dëshmi për Listën e punëtoreve se ka staf te mjaftueshëm minimum 15 duke i dëshmuar me kontrata ose para kontratë për këtë projekt.
Bazuar ne paragrafin 5.5 te FDT se dosjes se tenderit ; Afatet kohore për fillimin dhe / ose përfundimin e kontratës: janë 90 ditë.
Bazuar ne faktet e lartshënuara mund te konstatojmë se Punëtoret e grupit te OE nuk kane kontratë valide për këtë projekt .

Sa i përket këtij pretendimi Eksperti shqyrtues konstaton me sa vijon;

Mendimin e Ekspertit shqyrtues, ku shprehimisht konstaton me sa vijon;

"Ne baze te pasqyrës se listës se vitit 2021 rezulton se shumica e punëtoreve janë paguar vetëm për 3(tre) muajt e pare te vitit 2021 ndërsa kërkesë e AK-se ene FDT është qe pagesa e kontributeve se paku 6 muajt e fundit .Andaj nga dëshmitë e ofruar nga Operatori ekonomik i rekomanduar për kontrate rezulton se nuk ka ofruar listën e ATK-se me pagesë te kontributeve ne 6 muajt e fundit .rrjedhimisht pretendimi i OE ankues është i qëndrueshëm

Sa i përket pretednimit lidhur me Kereksen nr.4 te FDT-se;

Kërkesën nr.4 - **Një (1) inxhinjer i diplomuar i Gjeodezis (ose master)- me kontrat apo parakontrat ne emer te projektit – minimum 3 vite përvoj pune pas diplomimit.**
AK ka kërkuar nga OE qe te ofrojnë dëshmi dokumentare
Dëshmia 4 ;
Për stafin professional (inxhinierët) duhet te ken Diplomat-kopje, kontrata apo parakontrata në emer të projektit dhe CV-ja e nenshkruar nga vet inxhinjeret

Grupi i OE i propozuar për shpërblim te kontratës ka ofruar dëshmi dokumentare për Inxhinierin e Gjeodezisë Diplome me titull BAHCHELOR I GJEODEZISE, ka ofruar kopjen e diplomës për **Miridon Murat Kurteshi**, i cili nuk është **Inxhinier i Gjeodezisë** por **BAHCHELOR I GJEODEZISE** ndërkaq AK ka kërkuar Inxhinier te diplomuar ose me master.

Sa i përket këtij pretendimi Eksperti shqyrtues konstaton me sa vijon;
Lidhur me këtë pretendim ankimor Eksperti shqyrtues sqaron se "***Operatori ekonomik i propozuar për kontrate* *për Inxhinierin e Gjeodezisë Diplome me titull BAHCHELOR I GJEODEZISE, ka ofruar kopjen e diplomës për Miridon Kurteshi*** *i cili ka ofruar diplome nga Universiteti i Prishtinës Fakulteti i ndërtimtarisë dhe arkitekturës ne këtë diplome figuron Bachlor i Gjeodezisë i cili nuk është i barasvlershëm me titullin Inxhinier i Gjeodezisë..*
Rrjedhimisht pretendimi është i qëndrueshëm.

Sa i përket pretendimit te trete lidhur me kërkesën nr.6 te AK-se e cila ka te beje me;

Kërkesa 6 Lista e mjeteve te punës në dispozicion për realizimin e punimeve
-Kamion kipper Minimum 5 copë
Kamion për pastrimin e rrugëve Minimum 1 copë
Bulduzer minimum 15 ton Minimum 1 copë
Eskavator me goma minimum 14 ton Minimum 2 copë
Transportues per makineri minimum 35 ton Minimum 1 copë

AK ka kërkuar nga OE qe te ofrojnë dëshmi dokumentare;
Dëshmia 6 ,
Lista e pajisjeve – mjeteve të punës që OE duhet ti ketë të vetat apo të kontraktuara (apo me qira), të dëshmohen me kopje të librezave, deklaratë doganore apo ndonjë dëshmi tjetër.
Të dëshmohet se pajisjet motorike janë të regjistruara dhe kanë sigurim valid- Kopja e librezave të paisjeve

Grupi i OE i propozuar për shpërblim te kontratës ka ofruar dëshmi dokumentare për këto mjete ne kundërshtim me kërkesën e AK-se , Ne vijim po ofroj dëshmi mbi këtë pretendim për mjetin e punës ;
Për kërkesën ; **Transportues për makineri minimum 35 ton Minimum 1 copë, ka ofruar ;Gjysemrimorkio për bartjen e automjeteve ne emër te "Miruusha Comany " sh.p.k ka ofruar Librezën e qarkullimit për mjetin me targa te regjistrimit ; 03-632-XB, me afat te skaduar te regjistrimit. Regjistrimi i këtij mjeti ka skaduar me date 13.08.2021.**

Sa i përket këtij pretendimi Eksperti shqyrtues konstaton me sa vijon; Lidhur me këtë pretendim ankimor Eksperti shqyrtues sqaron se;

"Për plotësimin e kësaj kërkesë OE librezën e qarkullimit për pajisjen me nr. te tabelave 03-632 XB, kjo pajisje është marre me qira prej kompanisë Mirusha Company sh.p.k e cila është për ketë projekt , ketë libreze thuhet se pesha maksimale e ngarkesës se lejuar është 36100 , ndërsa validiteti i makinerisë i skaduar me date 13.08.2021, |Rrjedhimisht pretendimi është i qëndrueshëm".

Autoriteti kontraktues me date 25.03.2022 ka marre vendimin për dhënie te kontratës pa përfillur Mendimin e Ekspertit shqyrtues i cili ka rekomanduar

---

duke rrezikuar nënshkrimin e kontratës me një OE i cili është i pa përgjegjshëm ne kuptim te dispozitave te LPP-se.
AK gabimisht ka aplikuar dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme administrative i cili ne nenin135 thotë se afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është 30 dite nga fillimi i saj.
Për aktivitetet e prokurimit aplikohet ligji special, Ligji i Prokurimit publik i cili nuk përmban kurrfarë dispozite ne rastet kur kalon afati 34 ditor i marrjes së Vendimit te OSHP-se.
Vlen te theksohet qe nga data 31.03.2021 ne OSHP gjenden mbi 600 ankesa te pa zgjidhura.
Nga 531 tender qe janë bllokuar ne OSHP nen arsyetimin se kane skaduar te gjitha afatet ligjore, vetëm 143 autoritete kontraktuese kane vazhduar me aktivitetin e mëtejmë te prokurimit.
Këto autoritete kane pranuar Mendimin e Ekspertit shqyrtues ku janë hedhur poshtë ankesat si te pa baze, ndërkaq ne rastet kur Eksperti shqyrtues ka konstatuar se OE janë shpërblyer me kontrate pa i plotësuar kërkesat e AK te përcaktuara ne dosje te tenderit dhe ne Njoftimin për kontrate nuk kane vazhduar me tutje (Rasti i Komunës se Pejës).

PERFUNDIM

Pretendojmë se AK-Komuna e Pejës me Vendimin e vet për dhënie te kontratës ka bere shkelje te dispozitave te LPP-se dhe Legjislacionit sekondar duke mos respektuar fare Mendimin e Ekspertit shqyrtues, i cili ne raportin e tij fituesin e kontratës e shpall plotësisht ta pa përgjegjshëm

N3e si pale e interesit do te njoftojmë te gjitha institucionet relevante siç janë; Agjencinë Kundër korrupsion, Zyrën Kombëtare te Auditimit, Ministrinë e Punëve te Brendshme Komisionin Rregullativ te Prokurimit Publik.

- ***Të aprovoj ankesën OE;NSHT„Tissi "&" Bujar Shabani B.I. "Maja e Zezë, Peje, si të bazuar,***
- ***Të anuloj, Njoftimin për Vendimin e AK te datës 27.08.2021 i publikuar ne E-prokurim me date 28.08.2021 dhe***
- ***Vendimit për dhënie te kontratës te datës 25.03.2022,***
- ***Të kthej tenderin në Rivlerësim dhe vlerësimi të bëhet në pajtim me kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë , dosjes së tenderit, LPP si dhe Rregullat dhe UOPP si dhe Mendimin e Ekspertit Shqyrtues te dhënë ne Raportin e Ekspertizës .***

- Mbetemi me shpresë se Ankesa do të shqyrtohet pozitivisht.

Me nderime,
Lideri i Grupit;

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale

Kërkesa 1.Certifikata e Regjistrimit te Biznesit (ARBK)

Kërkesa 2.Regjistrimi i TVSH –së

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre vite të fundit financiare duhet te jetë jo më pak se 310.000.00 Euro.

Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar të qarkullimit vjetor për 3 vitet e fundit.

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat për projekte të ngjashme në vlerë prej 230.000.00 Euro në 3 (tri) vitet e shkuara, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë.

Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar punë të ngjashme të realizuara në 3vitet e shkuara.

Kërkesa 2

Të paraqitët stafi që do të angazhohet në këtë projekt, të cilët drejtpërdrejtë janë përgjegjës në ekzekutimin e punëve dhe në përgjithësi të projektit duke përfshirë edhe stafin profesionale. Stafi teknik (PUNONJËS) që do të kyçet në projekt -minimumi 15 punonjës

Kërkesa 3

Menaxheri i projektit Inxhinieri i diplomuar i ndërtimtarisë ose master drejtimi konstruktiv me kontratë apo para kontratë ne emër të projektit- me provoj pune minimum 3 vjeçare.

Kërkesa 4

Stafi i lartë profesional që do të kryqet në projekt minimum 2 inxhiniere , Një (1) inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë - me kontratë apo para kontratë ne emër te projektit – minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit.

Një (1) inxhinier i diplomuar i Gjeodezisë (ose master)- me kontratë apo para kontratë ne emër te projektit – minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit.

Kërkesa 5

Operatori ekonomik (në rast të Grupit të OE, së paku udhëheqësi i grupit) duhet të dëshmojë se sistemi manaxhues i ofertuesit përmbush kriteret e përcaktuara në fushën e ndërtimit të rrugëve së paku për këto ISO standarde

- ISO 9001 2015 - Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë
- ISO 14001 2015- Sistemi i Menaxhimin Mjedisor

Kërkesa 6 Lista e mjeteve te punës në dispozicion për realizimin e punimeve -Kamion kiper Minimum 5 copë, Kamion për pastrimin e rrugëve Minimum 1 copë, Bulduzer minimum 15 ton Minimum 1 copë, Eskavator me goma minimum 14 ton Minimum 2 copë, Transportues për makineri minimum 35 ton Minimum 1 copë

Kërkesa 7

Specifikimi teknik i detyrueshëm

Dëshmitë e kërkuara dokumentare të përshtatshmërisë profesionale

Evidenca 1 Certifikata e Regjistrimit të Biznesit (ARBK) -kopje

Evidenca 2 Certifikata e TVSH-së kopje.

Dëshmitë e kërkuara dokumentare mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

Raporti bankar (vërtetim) apo ndonjë dëshmi tjetër zyrtare financiare qe dëshmon qarkullimin financiare për tri vitet të fundit

N/A

Dëshmitë e kërkuara mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

Dëshmia 1

Një listë te kontratave të realizuara duke plotësuar, ANEKSIN 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose procesverbalet për kryerje të punëve

Dëshmia 2

Lista e punëtoreve me para kontrata minimum 15 punëtorë ose me Liste të ATK-së me pagës te kontributeve se paku 6 muaj te fundit,

Dëshmia 3

Për Menaxherin e projektit (inxhinieri) duhet te ketë Diplomën-kopje , vendim për Projekt menaxher i vulosur dhe nënshkruar nga Kompania si dhe CV e nënshkruar nga vetë inxhinieri .

Dëshmia 4

Për stafin profesional (inxhinierët) duhet te kenë Diplomat-kopje, kontrata apo para kontrata në emër të projektit dhe CV-ja e nënshkruar nga vet inxhinieret.

Dëshmia 5

Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me Certifikatat ISO valide (kopje)

Vërejtje Certifikatat e natyrës se njëjtë ISO më të avancuara pranohen Dëshmia 6 Lista e pajisjeve – mjeteve të punës që OE duhet ti ketë të vetat apo të kontraktuara (apo me qira), të dëshmohen me kopje të librezave, deklaratë doganore apo ndonjë dëshmi tjetër. Të dëshmohet se pajisjet motorike janë të regjistruara dhe kanë sigurim valid- Kopja e librezave të pajisjeve. Dëshmia 7 Deklaratë e O.E (e nënshkruar dhe e vulosur) mbi pranimin e specifikimeve teknike të detyrueshme të dhëna nga A.K

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

KOMUNA E PEJES shpërblen me kontratë ***Grup i Operatorëve Ekonomik Rahovica Comerce SH.P.K.; CAPITAL X FET SH.P.K.,*** ne vlere totale te ofertës: ***113.390,00 €***

VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË GOE "NSHT Tissi & Bujar Shabani B.I"

Lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, eksperti shqyrtues sqaron se pas dorëzimit të ekspertizës me nr. 675/21 të datës 22.09.2022, dhe në mungesë të bordit të OSHP-së nuk kemi vendim marrje lidhur me këtë lëndë. Me dt.24.03.2022 AK-ja ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës. AK-ja ka vendosur për dhënie të kontratës pa vendim të Panelit Shqyrtues të OSHP-së dhe kjo përgjegjësi bie mbi vetë AK-në. Pasi OE ankues në ankesën e tij ka ngritur pretendimet e njëjta nga ato të cilat i kishte parashtruar në ankesë herën e parë, tani në vijim i gjeni të përshkruara të njëjtat pasi që mendimi i ekspertit shqyrtues është i njëjte me po atë të raportit të ekspertizës me nr.675/21 të dt.22.09.2022.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 1

OE ankues thotë se GOE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesën e FDT-së të përcaktuar në nenin 9.2&9.2 të dosjes së tenderit kërkesa numër 2.Nga dëshmitë e ofruara nga GOE të rekomanduar për kontratë mund të konstatojmë se punëtorët e ofruar nga ana e GOE të rekomanduar për kontratë nuk kanë kontratë valide për këtë projekt për shkak se anëtari i GOE të rekomanduar për kontratë "Rahovica Comerce Sh.p.k ka prezantuar 57 punëtor së bashku me dëshmitë për pagesën e kontributeve vetëm për 3 muajt e parë të vitit 2021 ndërkaq anëtari tjetër i GOE të rekomanduar për kontratë " Capital X Fet Sh.p.k" janë prezantuar në listë me vetëm 14 punëtor për pagesën e kontributeve për 6 muajt e parë të vitit 2021. AK-ja ka kërkuar dëshmi nga ATK-ja për pagesën e kontributeve për 6 muajt e fundit.

Eksperti shqyrtues konstaton që kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: *"Të paraqitët stafi që do të angazhohet në këtë projekt, të cilët drejtpërdrejtë janë përgjegjës në ekzekutimin e punëve dhe në përgjithësi të projektit duke përfshirë edhe stafin profesionale. Stafi teknik (PUNONJËS) që do të kyçet në projekt -minimumi 15 punonjës"*

Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar:

"*Lista e punëtoreve me para kontrata minimum 15 punëtorë* ***ose*** *me Liste të ATK-së me pagës te kontributeve se paku 6 muaj te fundit*".

Për plotësimin e kësaj kërkese të FDT-së, operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka ofruar kontratat e punës ku shumica prej tyre janë nga janari i vitit 2021 deri në dhjetor të vitit 2021, në bazë të këtyre kontratave punëtorët janë të punësuar për të ushtruar detyra të punës por jo edhe për projektin adekuat, ndërsa si dëshmi janë ofruar listat e pagave nga administrata tatimore e Kosovës për vitet 2021, 2020, 2019 dhe 2018. Në bazë të pasqyrës së listës së vitit 2021 rezulton se shumica e punëtorëve janë paguar vetëm 3 muajt e parë të vitit 2021 ndërsa kërkesë e FDT-së është që pagesa e kontributeve së paku 6 muajt e fundit. Andaj nga dëshmitë e ofruar nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë rezulton se nuk ka ofruar listën e ATK-së me pagesë të kontributeve në 6 muajt e fundit. Rrjedhimisht pretendimi i OE ankues është i qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 2

OE ankues pretendon se GOE të rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesën nr.4 të kërkuar në nenin 9.1&9.2 të dosjes së tenderit. GOE i propozuar për kontratë ka ofruar dëshmi për inxhinier të gjeodezisë diplomën me titull Bachelor i gjeodezisë ka ofruar kopjen e diplomës për Miridon Murat Kurteshi, i cili nuk është inxhinier i Gjeodezisë por Bachelor i Gjeodezisë ndërkaq AK-ja ka kërkuar Inxhinier i diplomuar apo Master.

Eksperti shqyrtues konstaton që kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: "*Stafi i lartë profesional që do të kyqet në projekt minimum 2 inxhiniere ..... Një (1) inxhinier i diplomuar i Gjeodezisë (ose master)- me kontratë apo para kontratë ne emër te projektit – minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit*".

Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar:
"Për stafin profesional (inxhinierët) duhet te kenë Diplomat-kopje, kontrata apo para kontratë në emër të projektit dhe CV-ja e nënshkruar nga vet inxhinieret".

Lidhur me këtë pretendim ankimor eksperti shqyrtues sqaron se operatori ekonomik i propozuar për kontratë për inxhinier të Gjeodezisë ka ofruar z.Mirdon Kurteshi, i cili ka ofruar diplomën nga Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i ndërtimtarisë dhe arkitekturës, në këtë diplomë figuron që z. Kurteshi mori titullin Bachelor i Gjeodezisë. Andaj duke pas parasysh gradat e dhen nga Universiteti i Prishtinës rezulton se titulli Bachelor nuk është i barasvlershëm me titullin Inxhinier andaj pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i qëndrueshëm për faktin se operatori ekonomik i propozuar për kontratë më saktësisht diploma e inxhinierit të gjeodezisë nuk është ofruar konform kërkesës së DT-së dhe njoftimit për kontratë.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 3

OE ankues thotë se GOE i propozuar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesën nr.6 të kërkuar tek neni 9.1&9.2 të FDT-së. GOE i propozuar për kontratë ka ofruar dëshmi dokumentare në kundërshtim me kërkesat e AK-së. Në vijim po ofrojmë dëshmi mbi këtë pretendim për mjetin e punës. ”Transportues për makineri min. 35 ton Minimum 1 Copë” ka ofruar Gjysmë rimorkio për bartjen e automjeteve në emër të “Mirusha Company” Sh.p.k ka ofruar librezën e qarkullimit për mjetin me targa të regjistrimit 03-632-XB me afat të skaduar të regjistrimit. Regjistrimi i këtij mjeti ka skaduar me dt. 13.08.2021.

Eksperti shqyrtues konstaton që kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është*:* “*Lista e mjeteve te punës në dispozicion për realizimin e punimeve -Kamion kiper Minimum 5 copë, Kamion për pastrimin e rrugëve Minimum 1 copë, Bulduzer minimum 15 ton Minimum 1 copë, Eskavator me goma minimum 14 ton Minimum 2 copë, Transportues për makineri minimum 35 ton Minimum 1 copë”.*

Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar:

“*Lista e pajisjeve – mjeteve të punës që OE duhet ti ketë të vetat apo të kontraktuara (apo me qira), të dëshmohen me kopje të librezave, deklaratë doganore apo ndonjë dëshmi tjetër. Të dëshmohet se pajisjet motorike janë të regjistruara dhe kanë sigurim valid- Kopja e librezave të pajisjeve*”.

Për plotësimin e kësaj kërkese të DT-së operatori ekonomik i propozuar për kontratë ka ofruar librezën e qarkullimit për pajisjen me nr. te tabelave 03-632-XB,kjo pajisje është marrë me qira prej kompanisë “Mirusha Company” Sh.p.k e cila është për këtë projekt, në këtë librezë thuhet se pesha maksimale e ngarkesës së lejuar është 36100, ndërsa validiteti i makinerisë është i skaduar me dt. 13.08.2021. Rrjedhimisht pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i qëndrueshëm.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e GOE **"**NSHT Tissi & Bujar Shabani B.I" të aprovohet si e bazuara, dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në Rivlerësim.

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

Autoritetit Kontraktues - KK Pejë

Panelit Shqyrtues - OSHP

OE ankues - "NSHT Tissi & Bujar Shabani B.I"